

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"GLINT GLOBAL COMPANY" SHPK

Sot, me date 12 Gusht 2020, ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit Nr. 9901, dt. 14.04. 2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te nenshkruarit:

1. Shtetasi: **Z.SERKAN BILIK**, atesia Halit , i datelindjes 19.02.1974, shtetas Turk , lindur ne Agri dhe banues ne Izmir/Turqi, me Pashaporten Turke U13897523/27793021326 me afat deri me 10.01.2027.

2. Shtetasi: **Z.SAHIN TUNA VARDAR** , atesia Irfan, i datelindjes 27.11.1981, shtetas Turk,lindur ne Bornova dhe banues ne Izmir/Turqi,me Pashaporten Turke U20519720/45022245756 me afat deri me 03.08.2028

3.Shtetasi : **Z.ALFRED CELAMI**,atesia Aqif, i datelindjes 22.07.1981, shtetas shqiptetar, lindur ne Burrel/Mat dhe banues ne Durrës Rajoni 3.Rr.K.Kazanxhi, me Pasaporten Nr.BA7571124/I107221550 me afat deri më datë 10.06.2029

si themelues te shoqerise tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" SHPK, sot me date 12 Gusht 2020 , duke patur zotesine ligjore per te vepruar,

RAME DAKORD DHE KONTRAKTUAM

per sa vijon:

Neni 1: FORMIMI

Formohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **Shoqeria "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk.**

Neni 2: SELIA

Selia e Shoqerise Tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk eshte, ne adresen: Godina Flag Ship Pasuria Nr.4/63-N47, ZK 8514 me ndodhje ne Durres ,Rr'Skenderbej",

Neni 3: KOHEZGJATJA

Shoqeria Tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Filiali Durrës.

Neni 4: OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "GLINT GLOBAL COMPANY" Sh.P.K., do te kete per objekt aktiviteti, si me poshte:

- Import ,eksport , prodhim produktesh organike dhe bimore per pastrim
- Shitje me shumicë dhe pakice produktesh organike dhe bimore per pastrim
- Marketing
- Investim dhe menaxhim në fushen e veprimtarise ndertimore, per ndertimin e cdo lloj godine nje ose shumekateshe, civile, industriale, turistike, bujqesore, qendra biznesi, hotele, bar, restorante, Si dhe të tjera aktivitete të përgjithshme biznesi.

Neni 5: KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte ne likuditet ne shumen 100.000 Lek (njeqindemije) Lek i ndare ne 3 kuota i formuar dhe nenshkruar nga ne Ortaket sipas ketij kontributi:

- 1. Ortaku SERKAN BILIK kontribues me shumen 45.000 Lek e barabarte me 1 kuote me te drejte vendimore.*
- 2. Ortaku SAHIN TUNA VARDAR kontribues me shumen 45.000 Lek e barabarte me 1 kuote me te drejte vendimore.*
- 3. Ortaku ALFRED CELAMI kontribues me shumen 10.000 Lek e barabarte me 1 kuote me te drejte vendimore.*

Kontributi në të holla paguhet tërësisht dhe menjëherë. Kontributet në natyrë i kalojnë shoqërisë menjëherë përpara regjistrimit pranë OKR-së.

Neni 6: ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise Tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk jane Asambleja e Shoqerise orataket dhe administratori i saj .Fusha e veprimit, perberja dhe funksionimi i organeve drejtuese, emerimi dhe shkarkimi i anetareve dhe çeshtje te tjera te ketyre organeve rregullohen sipas Statutit te Shoqerise, qe eshte pjese perberese e ketij Akti, si dhe me dokumente te tjera te brendshme te shoqerise qe do te miratoje Asambleja e saj.

Neni 7:

Shoqeria Tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk do te administrohet nga 1 (nje) administrator ligjor qe eshte Z.ALFRED CELAMI , i cili emerohet per nje periudhe **5 vjeçare**. Administratori ka te gjitha fuqite per administrimin e zakonshem e te jashtezakonshem dhe per perfaqesimin e shoqerise tek te tretet si dhe ne gjykata.

Neni 8:

Shoqeria Tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk zhvillon aktivitetin e saj sipas dispozitave normative urdheruese te Ligjit 9901, dt.14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 9: VULA E SHOQERISE

Shoqeria ka vulen e saj zyrtare me permbajtje: Shoqeria Tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk Durrës, Shqiperi.

Neni 10: MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "GLINT GLOBAL COMPANY" shpk rregullohen sipas dispozitave te Statutit te saj.

Neni 11: BILANCI DHE TE ARDHURAT

Viti financiar i shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti.
Ne mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe hartojne nje raport me shkrim per administrimin.
Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Asamblese se Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 12:

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale dhe te atyre ndaj te treteve, ndahen midis ortakeve te shoqerise ne perputhje me kuotat e secilit ne formimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 13: PRISHJA E SHOQERISE

Shperberja e Shoqerise Tregtare GLINT GLOBAL COMPANY "shpk, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredolloj shkak, duke vepruar sipas kritereve te parashikuara ne Statut.

Neni 14: DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Te gjitha kundershtrimet eventuale midis ortakeve te shoqerise, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Durrësit. Por kundershtrimet mund te zgjidhen edhe nga nje gjykate brenda apo jashte Shqiperise, ne rast se ortaket kane rene dakord midis tyre.

Neni 15: NENSHKRIMI

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare ne gjuhen **shqipe**, me permbajtje e vlera te njenjta juridike dhe pasi lexohet me ze, duke u perkthyer verbalisht ne gjuhen Turke nga shtetasi Z.ALFRED CELAMI,atesia Aqif, i datelindjes 22.07.1981, shtetas shqipetar, lindur ne Burrel/Mat dhe banues ne Durrës Rajoni 3.Rr.K.Kazanxhi, kuptohet dhe miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te Shoqerise tregtare me ortakeri "GLINT GLOBAL COMPANY" Shpk, nenshkruhet prej tyre ne te gjithë ekzemplaret duke vene emri, mbiemri dhe firmat origjinale.

ORTAKET THEMELUES

TE SHOQERISE TREGTARE ME ORTAKERI "GLINT GLOBAL COMPANY" Shpk"

Miratues te ketij Statuti

1.Z.

2.Z.

3.Z.

Perktheu aktin ne gjuhen Turke:

Z. Alfred Celami